



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 172, datë 25.05.2021

**PËR CAKTIM E ZNJ. ANITA JELLA, NËPËRMJET PROCEDURËS SË
NGRITJES NË DETYRË, NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DURRËS**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6 dhe 52 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 28 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë znj. **Anita Jella** në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
2. Znj. Anita Jella të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nga data 18.05.2021 - 17.05.2024.
3. Të ndërpresë caktimin e përkohshëm si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
4. Të njoftohen për këtë vendim prokurore Anita Jella, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Prokurori i Përgjithshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
GENT IBRAHIMI



ANËTAR
KOSTAQ BELURI



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
NURIHAN SEITI




ANËTAR
ELOIDA GOXHI



ANËTAR
ESMERALDA KESHI




ANËTAR
MOISI DUDA



ANËTAR
VATË STAKA



ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
TARTAR BAZAJ

